



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 233 Prot.

Tiranë, më 11. 11. 2020
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTUAR: AGJENCISË SE PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

Në zbatim të Vendimit Nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave (VKM) “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr. 171 datë 27.09.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë”, dhe VKM Nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësme drejtuese”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për **1 (një)** vend të lirë pune në pozicionin e **Specialistit pranë Sektorit të Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor, ose ekuivalent me të, me formim në një nga fushat: shkenca sociale, shkenca humane dhe/ose shkenca natyre;
2. Të zotërojë gjuhën angleze, të çertifikuar në një nga testet ndërkombëtare të njohura nga MASR, me dëshmi në nivel mbi mesataren;
3. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë;
4. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në profesion që ka lidhje me pozicionin e shpallur, si dhe kandidatët që kanë përvojë pune në arsimin e lartë ose që kanë lidhje me arsimin e lartë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë eksperiencë pune të paktën 5 (pesë) vjeçare në administratën publike;
2. Të ketë dhe të dëshmojë njohuri mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

3. Të ketë dhe të dëshmojë njohuri mbi legjislacionin bazë të arsimit të lartë në Shqipëri dhe njohuri mbi institucionet, programet e studimit, procedurat, kriteret dhe aktet nën-ligjore të arsimit të lartë në Shqipëri;
4. Të ketë dhe të dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikuese;
5. Të ketë dhe të dëshmojë aftësi për të punuar në grup.

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*);
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal;
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar;
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces;
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar;
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar;
7. Fotokopje të dëshmimeve të kualifikimeve të kryera, të noterizuara;
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm;
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj të shkruar dhe folur, dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 25.11.2020, ora 12.00 në adresën e mëposhtme:

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit “Qemal Stafa”
Tel: 4 22 43 423**

Mund të aplikojnë edhe kandidatë që janë pjesë e stafit të ASCAL. Për këta kandidatë kërkohet plotësimi i dokumentacionit sipas pikës III ose përditësimi i atij ekzistues.

Njoftimi të publikohet edhe në web site të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë:

www.ascal.al

DREJTORI


Elvin Gjevori



Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al